



**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

**STANDARDI I PROFESIONIT**

**KULTIVUES I PERIMEVE**

**Sektori: Bujqësi**

**Kodi ISCO 88: 6112.07 Kultivues i perimeve**

**ISCO 08 : 6111 Kultivues i kulturave të fushës dhe perimeve**

**Data e miratimit:**

Ky Standard i Profesionit është zhvilluar me përkrahje të projektit ALLED “Harmonizimi i arsimit me kërkesa të tregut të punës (Kosovë)”

**Grupi punues:**

**Udhëheqës i grupit:**

Josip Juračak, PhD

**Anëtarë:**

Sevdije Muhaxheri, Trajnere QAP

Bunjamin Alili

**Data e miratimi:**

**I vlefshëm:** Për periudhë 5 vjeçare

**Kodi i profesionit:** 6111 (ISCO 08)

## **Profesioni: Kultivues i perimeve**

### **Përshkrimi i profesionit**

Kultivuesit e perimeve kanë mundësi të punojnë në ndërmarrje të llojeve të ndryshme që merren me kultivimin e perimeve. Llojet e ndërmarrjeve mund të dallojnë varësisht nga lloji i perimeve që kultivojnë. Kultivimi mund të bëhet ose në fushë të hapur ose në serë. Praktikrat bujqësore moderne dhe garuese fokusohen në specializim, e kjo qëndron veçanërisht për prodhime të intensitetit të lartë siç është prodhimi i perimeve.

Detyrat specifike të një prodhuesi të perimeve mund të dallojnë varësisht nga lloji i ndërmarrjes, por në përgjithësi, ato përfshijnë: planifikimin e prodhimit në përputhje me burimet në dispozicion dhe me burimet e arritshme; kultivimin e dheut dhe përgatitjen për mbjellje; prodhimin e fidanëve/ rasadit; mbjelljen; plehërimin; ujitjen; kontrollin për baroja, insekte dhe sëmundje; vjeljen dhe veprimet e pas vjeljes.

Për të qenë në gjendje të veprojë si i/e vetëpunësuar, përveç aktiviteteve operacionale të përmendura më lartë, prodhuesi është i obliguar të kryej edhe detyra administrative dhe komerciale.

Gjatë kryerjes së detyrave të tij, kultivuesi duhet të zbatojë praktika të mira sa i përket shëndetit dhe sigurisë në punë, mbrojtjes së ambientit dhe sigurisë së ushqimit.

Për të siguruar performancë të duhur dhe efikase në këtë profesion, duhet të plotësohen kushte që kanë të bëjnë me hapësirën e punës, veglat adekuate, pajisjet, lëndën e parë, materialin për paketim, dhe udhëzimet me shkrim. Kushtet minimale që kërkohen duhet të sigurojnë performancë të lehtë dhe efikase, çoftë në fushë të hapur apo në serë.

Në kryerjen e këtij profesioni punëtorët mund t'u ekspozohen kushteve të vështira të punës: temperaturë e lartë, nivel i lartë i lagështisë, tehe të mprehta, objekte rrotulluese, dhe substanca toksike. Varësisht nga organizimi i punës, orari i punës mund të përfshijë punë gjatë natës, ditëve të pushimit apo edhe gjatë fundjavës. Pritet që kandidatët të kenë shkathtësi të mira motorike, sens të mirë të shikimit dhe të dëgjuarit. Kushtet e punës mund të shkaktojnë probleme tek personat me alergji ndaj polenit si dhe tek personat që janë alergjik ndaj substancave të caktuara kimike që përdoren në bujqësi.

**Profesioni: Kultivues i perimeve**

Nr.	Funksioni	Përshkrimi i funksionit
1	Planifikon dhe përgatit aktivitetet në fermën e perimeve	Ky funksion ka të bëjë me planifikimin e aktiviteteve në fermë, përgatitjen e vendit të punës dhe përgatitjen e materialit për prodhim. Funksioni po ashtu përfshin, kontrollimin e kushteve teknike të veglave dhe pajisjeve në fermë. Ky funksion varet shumë nga forma e prodhimit (fushë e hapur apo serë), kërkesat teknologjike, burimet në dispozicion dhe nga perceptimi i nevojave të tregut.
2	Kryen detyra operative në prodhimin e perimeve	Ky funksion ka të bëjë me kryerjen e aktiviteteve operative në fermën e perimeve, çoftë në fushë të hapur apo në serë. Detyrat operative përfshijnë përgatitjet e dheut dhe të kushteve për mbjellje, mbjelljen e farave dhe prodhimin e fidanëve/ rasadit, mbjelljen, kultivimin e dheut, kontrollin për baroja dhe insekte, ujitjen dhe plehërimin. Detyrat duhet të kryhen në linjë me rregulloret, standardet dhe udhëzimet për aplikim të praktikave më të mira të punës, përfshirë sigurinë dhe pastërtinë në punë, dhe mbrojtjen e ambientit.
3	Kryen vjeljen dhe aktivitetet e pas vjeljes	Ky funksion ka të bëjë me kryerjen e detyrave operative në fermë që ndërlidhen me procesin e vjeljes, mbledhjes, klasifikimit, matjes, transportimit dhe deponimit të produkteve. Këto aktivitete mund të kryhen me dorë ose në mënyrë mekanike. Varësisht nga lloji i produktit, aktivitetet e pas vjeljes përfshijnë pastrimin, kategorizimin, paketimin dhe etiketimin e produkteve para deponimit. Pos kësaj, ky funksion përfshin vendosjen dhe kontrollimin e kushteve të depos, mirëmbajtjen e pastërtisë, menaxhimin e mbeturinave, dhe zbatimin e standardeve për siguri të ushqimit.
4	Kryen detyra administrative dhe komerciale	Ky funksion ka të bëjë me kryerjen e detyrave administrative dhe komerciale që janë të nevojshme për të udhëhequr punët në një ndërmarrje të vogël për prodhimin e perimeve. Funksioni përfshin kujdesin ndaj dokumenteve që kanë të bëjnë me biznesin, mbajtjen e shënimeve, kryerjen e llogaritjeve të thjeshta; dhe promovimin e shitjen e produkteve të fermës.

### Funksioni 1: Planifikon dhe përgatit aktivitetet në fermën e perimeve

Ky funksion ka të bëjë me planifikimin e aktiviteteve në fermë si dhe përgatitjen e vendit të punës. Po ashtu ky funksion përfshin përgatitjen dhe kontrollimin e materialit të prodhimit dhe veglat e pajisjet për fermë. Po ashtu këtu përfshihet edhe aktivitete që kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemeve të vërejtura në vendin e punës para se të fillojë procesi i punës.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kryesore dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Planifikon aktivitetet në fermën e perimeve	<p>Planifikon fushën/ parcelën për prodhim dhe sasinë e specieve të ndryshme në linjë me kërkesat teknologjike.</p> <p>Planifikon shitjen totale të specieve të ndryshme në raport me kushtet e tregut.</p> <p>Përgatit një listë të aktiviteteve operative me periudha të përshtatshme kohore.</p>	<p>Njohuri për lloje të ndryshme të specieve të perimeve njohuri mbi kërkesat e prodhimit për perime të ndryshme.</p> <p>Njohuri për materialin e prodhimit që kërkohet në fermë</p> <p>Njohuri për hapat e kultivimit të perimeve.</p>	<p>Interpretimi i udhëzimeve me shkrim për përdorim të veglave dhe pajisjeve.</p> <p>Hartimi i planeve mbështetëse bazuar në të dhënat në dispozicion</p> <p>Vizatimi i planit të parcelës ku do të mbjellën perimet</p> <p>Dallimi i dështimeve dhe problemeve në vendin e punës.</p>	<p>Shkathtësi të mira motorike. Sens të mirë të shikimit, nuhatjes dhe dëgjimit .</p> <p>Komunikim në gjuhën amtare (në të shkruar, lexuar, folur dhe dëgjuar).</p> <p>Kryerja e kalkulimeve bazike me numra të plotë dhe të pjesshëm.</p> <p>Aftësi për të punuar në kushte të punës me temperaturë të lartë dhe të zhurmshme.</p>
Përgatit aktivitetet në fermën e perimeve	<p>Përzgjedh dhe përgatit llojet dhe sasinë e nevojshme të materialit për prodhim.</p> <p>Përgatit dhe kontrollon veglat dhe pajisjet në linjë me aktivitetet e planifikuara.</p> <p>Rregullon vendin e punës në përputhje me aktivitetin e caktuar.</p> <p>Krijon kushtet e kërkuara në serë.</p> <p>Dallon dhe rregullon defekte të thjeshta në vegla dhe pajisje.</p>	<p>Njohuri për veglat dhe pajisjet e zakonshme të fermës.</p> <p>Njohuri për dështimet tipike të veglave dhe pajisjeve në fermë.</p>	<p>Zgjidhja e problemeve që janë të lehta për eliminim në vendin e punës.</p> <p>Përdorimi i mjeteve dhe materialeve për pastrim.</p> <p>Aplikimi i mjeteve mbrojtëse gjatë punës.</p>	

**Kushtet që kërkohen për kryerjen e funksionit:**

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion: tavolinën e punës dhe pajisjet e zyrës; dhe nyjat sanitare. Me që disa aktivitete mund të kryhen në mënyrë më efikase me anë të teknologjisë kompjuterike, kompjuteri me printer dhe me qasje në internet rekomandohet për këtë funksion.

Përveç kushteve të përmendura më lartë, vë vendin e punës duhet të jenë në dispozicion edhe si vijon: rrobat e punës, mbathjet dhe mjetet mbrojtëse; udhëzuesit ose manualët e veglave dhe pajisjeve; shenjat dhe udhëzimet për shëndet dhe siguri në punë.

**Kërkesat e vlerësimit:**

Testi me shkrim, pyetje dhe përgjigje duhet të përdoren për të vlerësuar saktësinë e njohurive të kandidatit.

Kandidati duhet t'i nënshtrohet vlerësimit praktik në kushte të punës. Mbikëqyrja duhet të bëhet për të vlerësuar kryerjen dhe saktësinë e aktiviteteve që kanë të bëjnë me planifikimin përgatitjeve tjera për punë.

**Funksioni 2:** Kryen detyra operative në prodhimin e perimeve.

Ky funksion përfshin detyra operative në fermën e perimeve. Detyrat mund të kryhen në fushë të hapur apo në serë. Ato përfshijnë si vijon: përgatitjet e dheut dhe të kushteve për mbjellje, mbjelljen e farave dhe prodhimin e fidanëve/ rasadit, mbjelljen, kontrollin për baroja dhe insekte, ujitjen dhe plehërimin. Detyrat duhet të kryhen në linjë me rregulloret për shëndet dhe siguri në punë, praktikatat më të mira për menaxhim të mbeturinave dhe praktika tjera që kontribuojnë në sigurinë e ushqimit dhe mbrojtjen e ambientit.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kryesore dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Kryen detyra operative për prodhimin e perimeve	<p>Përgatit dheun dhe kushtet për mbjellje në përputhje me kërkesat e kulturës.</p> <p>Mbjell kulturat në mënyrën dhe kohën e duhur.</p> <p>Përdor pajisjet për ujitje për të ujitur bimët sipas nevojës.</p> <p>Aplikon plehërimin në mënyrë të sigurtë dhe efikase në linjë me udhëzime.</p> <p>Zbaton masat për kontroll të baroja dhe insekte në përputhje me udhëzimet dhe me kushtet e bimës.</p> <p>Cakton kushtet optimale në serë në përputhje me nevojat e bimës.</p> <p>Bën ushqimin e zakonshëm të bimëve me kohë dhe në mënyrën e duhur.</p>	<p>Karakteristikat themelore të llojeve kryesore të dheut</p> <p>Llojet e zakonshme të specieve të perimeve dhe kultivarëve.</p> <p>Fazat e shumimit dhe rritjes së perimeve.</p> <p>Njohuri të përgjithshme për llojet dhe kultivarët e perimeve.</p> <p>Njohuri bazike për veglat dhe pajisjet për kultura të ndryshme dhe hortikulturë.</p> <p>Insektet më të zakonshme që sulmojnë speciet më të zakonshme të perimeve</p> <p>Metodat e parandalimit dhe trajtimit të bimëve që sulmohen nga insektet në prodhimin e perimeve në formë konvencionale dhe organike</p> <p>Mënyrat më të zakonshme për</p>	<p>Respektimi i udhëzimeve për përdorim të veglave dhe pajisjeve.</p> <p>Respektimi i udhëzimeve që kanë të bëjnë me procesin e prodhimit</p> <p>Përdorimi i veglave të dorës në fermë.</p> <p>Përdorimi i pajisjeve të zakonshme mekanike në fermë.</p> <p>Përcaktimi i saktë i kohës, sasisë, dhe këndit.</p> <p>Dallimi i problemeve në material dhe në pajisje</p> <p>Zgjidhja e problemeve</p>	<p>Komunikim në gjuhën amtare (në të shkruar, lexuar, folur dhe dëgjuar).</p> <p>Kryerja e kalkulimeve bazike me numra të plotë dhe të pjesshëm.</p> <p>Shkathtësi të mira motorike</p> <p>Sens të mirë të shikimit dhe dëgjimit</p> <p>Qëndrueshmëri fizike</p> <p>Tolerancë për të punuar në kushte të vështira</p> <p>Punë në qift dhe në grup</p> <p>Tolerancë ndaj orarit të ndryshueshëm të punës.</p>

<p>Kujdeset për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe për mbrojtjen e mjedisit</p>	<p>Zbaton masa të përshtatshme në raport me rreziqet potenciale të shëndetit dhe sigurisë në punë.</p> <p>Mban pastër mjedisin e punës duke u kujdesur për mbrojtjen e ambientit.</p> <p>Ndërmerr veprime të përshtatshme në rast të prishjeve apo dështimeve gjatë procesit të prodhimit.</p> <p>Menaxhon mbeturinat në vendin e punës në mënyrën e duhur.</p>	<p>mbrojtjen e bimëve që përdoren në prodhimin konvencional dhe organik të perimeve</p> <p>Plehëruesit organik dhe inorganik dhe substancat tjera ushqyese të bimëve</p> <p>Rregullat kryesore për shëndet dhe siguri në punë</p> <p>Rregullat kryesore për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e ambientit në hortikulturë</p>	<p>që janë të lehta për eliminim në vendin e punës.</p> <p>Aplikimi i mjeteve mbrojtëse gjatë punës.</p> <p>Aplikimi i praktikave të mira për menaxhim të mbeturinave.</p>	
---	---	--	--	--

#### **Kushtet që kërkohen për kryerjen e funksionit:**

Për të kryer këtë funksion nevojitet një parcelë e tokës ose një serë. Duhet të jenë në dispozicion vegla manuale ose mekanike (karrocë dore, grabujë, shati, kazma, tërfurku, pajisje për mbjellje të farës dhe fidanëve, gërshëre, vegla për mpresje, kontejner të madhësive të ndryshme, e kështu me radhë). Varësisht nga lloji dhe madhësia e fermës, punëtori duhet të jetë i pajisur me makina si kositëse, traktor me pajisje përcjellëse (plugu, disqet, frezat, rula, makinë për mbjellje të farave dhe fidanëve, shpërndarëse të plehut, spërkatëse, rimorkio, e kështu me radhë). Për ujitje nevojiten pompat dhe pajisje për shpërndarje të ujit. Serat duhet të pajisen me pajisje për ngrohje dhe ventilim.

Për të bërë këto punë, ky funksion kërkon lëndë të parë dhe furnizime për prodhime të ndryshme: fara dhe fidanë/ rasad, vazo dhe mjete për mbjellje, ushqim, plehra të ndryshme, herbicide dhe pesticide tjera, ujë, shporta dhe thasë për mbeturina.

Pos kësaj, në vendin e punës duhet të jenë në dispozicion edhe si vijon: rrobat e punës, mbathjet dhe mjetet mbrojtëse; udhëzuesit ose manualët e veglave dhe pajisjeve; shenjat dhe udhëzimet për shëndet dhe siguri në punë.

#### **Kërkesat e vlerësimit:**

Testi me shkrim, pyetje dhe përgjigje duhet të përdoren për të vlerësuar saktësinë e njohurive të kandidatit për speciet e perimeve, kultivarët dhe kërkesat e tyre; për karakteristikat bazë të dheut dhe mënyrave të mbjelljes, si dhe për kontrollin e barojave dhe sëmundjeve të bimës.



Kandidati duhet t'i nënshtrohet vlerësimit praktik në kushte të punës. Mbikëqyrja duhet të bëhet për të vlerësuar kryerjen dhe saktësinë e aktiviteteve kyçe që ndërlidhen me kriteret e performancës.

### Funksioni 3: Kryen vjeljen dhe aktivitetet e pas vjeljes.

Ky funksion ka të bëjë me kryerjen e detyrave operative në fermë që ndërlidhen me procesin e vjeljes dhe me detyrat që pasojnë deri sa të vendoset produkti në depo. Këto aktivitete mund të kryhen me dorë ose në mënyrë mekanike. Varësisht nga lloji dhe qëllimi i produktit, aktivitetet e pas vjeljes përfshijnë pak a shumë aktivitetet e njëjta. Pos kësaj, ky funksion përfshin vendosjen dhe kontrollimin e kushteve të depos, mirëmbajtjen e pastërtisë, menaxhimin e mbeturinave, dhe zbatimin e standardeve për siguri të ushqimit gjatë dhe pas vjeljes.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kryesore dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Vjel ose mbledh perimet	Kontrollon pjekurinë e specieve të ndryshme të perimeve në raport me qëllimin përfundimtar. Vjel perimet me dorë në mënyrë efikase dhe në kohën e duhur. Vjel perimet duke përdorur në mënyrën e duhur pajisjet adekuate. Kontrollon dhe mban veglat dhe pajisjet për vjelje në rregull dhe funksionale.	Klasat e perimeve për speciet më të zakonshme. Shenjat e pjekjes së perimeve për vjelje. Pajisjet manuale dhe mekanike për vjelje. Pajisjet manuale dhe mekanike për transportim. Pajisjet manuale dhe mekanike për klasifikim.	Respektimi i udhëzimeve për përdorim të veglave dhe pajisjeve. Përdorimi i mjeteve manuale për procesin e vjeljes dhe të pas vjeljes. Përdorimi i mjeteve mekanike për procesin e vjeljes dhe të pas vjeljes. Përcaktimi me saktësi i kohës, sasisë, gjatësisë dhe këndit. Vërejtja e problemeve në material dhe në pajisje Zgjidhja e problemeve që janë të lehta për	Komunikim në gjuhën amtare (në të shkruar, lexuar, folur dhe dëgjuar). Kryerja e kalkulimeve bazike me numra të plotë dhe të pjesshëm. Shkathtësi të mira motorike Sens të mirë të shikimit, nuhatjes, prekjës dhe dëgjimit Aftësi për të punuar në kushte të vështira dhe të zhurmshme Respektimi i normave etike sa i përket prodhimit të ushqimit Tolerancë ndaj orarit të ndryshueshëm të punës.
Kryen aktivitetet pas vjeljes	Klasifikon perimet e vjela sipas standardeve nëse kërkohet Transporton produktet e vjela me kohë dhe me dëme e humbje minimale Paketon perimet e vjela në mënyrën e duhur. Deponon perimet në kushte adekuate.	Transportimi dhe paketimi i kontejnerëve për perime. Qëndrueshmëria e perimeve në depo. Kushtet e deponimit të perimeve. Siguria e ushqimit dhe kërkesat e cilësisë gjatë vjeljes dhe pas vjeljes.		

	<p>Etiketon dhe ngarkon perimet për shpërndarje të mëtejme.</p> <p>Mirëmban mbeturinat e fushës në mënyrën e duhur.</p> <p>Pastron seren dhe zhvendos mbetjet në mënyrën e duhur.</p>	<p>Rregullat kryesore për shëndet dhe siguri në punë</p> <p>Rregullat kryesore në lidhje me menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e ambientit në hortikulturë</p>	<p>eliminim në vendin e punës.</p> <p>Aplikimi i mjeteve mbrojtëse gjatë punës.</p> <p>Aplikimi i praktikave të mira për menaxhim të mbeturinave.</p>	
--	---	--	---	--

**Kushtet që kërkohen për kryerjen e funksionit:**

Për të kryer këtë funksion, punëtori duhet të ketë në dispozicion si vijon: serë ose fushë me perime; pajisje manuale ose mekanike për vjelje; pajisje për transportim; vegla dhe materiale për klasifikim, paketim dhe etiketim manual ose mekanik; vend deponim me kushte optimale për perime të caktuara.

Pos kësaj, në vendin e punës duhet të jenë në dispozicion edhe si vijon: rrobat e punës, mbathjet dhe mjetet mbrojtëse; udhëzuesit ose manualët për klasifikim, paketim dhe deponim të perimeve;; shenjat dhe udhëzimet për shëndet dhe siguri në punë.

**Kërkesat e vlerësimit:**

Testi me shkrim, pyetje dhe përgjigje duhet të përdoren për të vlerësuar saktësinë e njohurive të kandidatit për klasat e perimeve, llojet e paketimeve dhe kushtet e deponimit.

Shkathtësitë e punëtorit duhet të vlerësohen në kushte të punës. Mbikëqyrja duhet të bëhet për të vlerësuar kryerjen dhe saktësinë e aktiviteteve kyçe që ndërlidhen me kriteret e performancës.

#### Funksioni 4: Kryen detyra administrative dhe komerciale

Ky funksion ka të bëjë me kryerjen e detyrave administrative dhe komerciale që janë të nevojshme për të udhëhequr punët në një ndërmarrje të vogël për prodhimin e perimeve. Funksioni përfshin kujdesin ndaj dokumenteve që kanë të bëjnë me biznesin, mbajtjen e shënimeve, kryerjen e llogaritjeve të thjeshta; dhe promovimin e shitjen e produkteve të fermës.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kryesore dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Kryen punë administrative	<p>Mban shënime për llojet dhe sasi të materialeve për përpunim dhe produkteve.</p> <p>Bën kalkulime elementare për të caktuar të hyrat, kostot dhe çmimin.</p> <p>Kujdeset për dokumentacionin për të siguruar mbajtje të saktë të llogarive.</p>	<p>Njohuri për formularët dhe dokumentacionin e zakonshëm të biznesit.</p> <p>Njohuri për terminologjinë bazike buxhetore.</p> <p>Njohuri për kërkesat ligjore sa i përket shitjes së perimeve.</p>	<p>Saktësi në mbajtjen e shënimeve për biznesin.</p> <p>Mbajtja në rregull e dokumentacioni të biznesit.</p> <p>Kalkulime të thjeshta financiare.</p> <p>Lëshimi i dokumenteve që kanë të bëjnë me shitjen.</p>	<p>Komunikim në gjuhën amtare (në të shkruar, lexuar, folur dhe dëgjuar).</p> <p>Kryerja e kalkulimeve bazike me numra të plotë dhe të pjesshëm.</p> <p>Tolerancë ndaj orarit të ndryshueshëm të punës.</p>
Kryen punë komerciale	<p>Ndërton dhe dekoron pikat e shitjes sipas kërkesave të produktit dhe sipas preferencave të blerësve.</p> <p>Promovon produktet duke përdorë teknika adekuate të promovimit</p> <p>Lëshon fatura dhe oferta të hartuara në mënyrën e duhur.</p> <p>Kryen shitje në përputhje me praktikën më të mirë dhe me legjislacionin përkatës</p>	<p>Njohuri për forma të thjeshta të promovimit.</p> <p>Njohuri për kërkesat për shëndet dhe siguri në punë.</p>	<p>Përdorimi i pajisjeve të teknologjisë informative për komunikim nëse janë në dispozicion</p> <p>Përdorimi i pajisjeve të teknologjisë informative në zyrë nëse janë në dispozicion</p> <p>Dekorimi i pikës së shitjes.</p> <p>Komunikim oral dhe</p>	

			me shkrim me blerësit.	
--	--	--	------------------------	--

**Kushtet që kërkohen për kryerjen e funksionit:**

Për të kryer këtë funksion, punëtori duhet të ketë në dispozicion si vijon: tavolinën e punës; pajisjet për zyrë; shembuj dhe formularë për korrespondencë biznesore në formë të shtypur dhe elektronike, kalkulator, telefon dhe pikë shitje të mobiluar.

Pos kësaj, për kryerjen e këtij funksioni rekomandohet të jenë në dispozicion kompjuteri me printer dhe me lidhje në internet ose regjistër të keshit.

**Kërkesat e vlerësimit:**

Testi me shkrim dhe pyetje - përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe shkathtësitë që ndërlidhen me aktivitetet kyçe. Vlerësimi duhet të përfshijë kalkulime.

Kandidati duhet të vlerësohet për performancën e tij/ saj në kryerjen e aktiviteteve si vijon: hartimi i dokumenteve të biznesit, shitja. Vlerësimi duhet të bazohet në krahasimin mes arritjeve të kandidatit në raport me praktiken e rekomanduar dhe me kriteret e performances.